

# Shtëpia ime duhet të shitet! Çka duhet të bëj?

Gjithnjë e më shpesh në qytetin tonë, shtëpitë që jepen me qera i ndërrojnë pronarët me çmime spekuluese që më vonë të bëjnë përmirësime luksoze ose të rrënohen tërësisht. Por edhe pa u shitur pasojnë renovime gjithnjë e më të shpeshta ose largimet nga

banesat. Banesat me qira te arsyeshme shndërrohen në banesa me qiraxhi pronarë ose pas renovimeve me qira te larta. Hapësira e banimit bëhet si mjet fitimi. Vetëm një numër i vogël i banuesve i goditur nga kjo dukuri arrijnë të mbrohen apo kundërshtojnë.



«Vila Carmen» është rrënuar në vitin 2016 dhe të gjithë qiraxhinjtë janë dëbuar.

# Kush është kjo sindikatë e shtëpive që jepen me qira?

Sindikata e shtëpive me qira është një shoqatë nderi (jo përfituese) e cila merret me gjetjen dhe mirëmbajtjen e hapësirave banuese me çmime të arsyeshme dhe të pagueshme. Mundësisht shumë shtëpi duke u bërë pronë e shoqatës i ikin mundësive të spekulimeve. Parimi I shoqatës së banuesve mundëson shumë përparësi për banuesit.

- kushte të përshtatshme banimi
- qira të përshtatshme falë përdorimit të arsyeshëm të qirave
- te rastet e përmirësimeve dhe investimeve është e mundur shfaqja e mendimeve tuaja
- pjesëmarrja e drejtë dhe e njëjtë financiare e anëtareve-banues

## Kontakti

Genossenschaft Miethäuser Syndikat  
c/o Interprofessionelle Gewerkschaft der ArbeiterInnen IGA  
Oetlingerstrasse 74  
4057 Basel  
genossenschaft@mietshaeusersyndikat.ch  
www.mietshaeusersyndikat.ch



Genossenschaft  
Miethäuser Syndikat

**Shtëpitë untakojnë atyre,  
të cilët banojnë në to!**

**DIE HÄUSER  
DENEN, DIE  
DRIN WOHNEN!**

# Parapërgatitja e blerjes kolektive të shtëpive

## 1. Kontaktimi me pronarët

Që shtëpitë të mundë të blihen në tregun aktual të banesave, pa qenë e detyrueshme ngritja qirasë me çmime të pa pagueshme, kontakti me shitësit apo shitëset është vendimtarë. Kështu është e mundur të zhvillohet një simpati. Thuani mendimet tuaja njëri tjetrit dhe bisedoni bashkërisht rreth pyetjeve për shtëpinë. Nëse ju jepet mundësia atëherë i rrëfeni pronarit të shtëpisë dëshirat tuaja, tregoni atij se dëshironi të banoni sam e gjate që është e mundur në këtë shtëpi duke përmendur mundësinë që shtëpia të kalon në pronë të përbashkët me banuesit-qiraxhinjtë tjerë të shtëpisë.

Nëse kjo nuk është e mundur, keni parasysh të gjeni rrugë për të ushtruar kërkesa dhe presion mbi pronarët (shihë më gjerësisht)

## 2. Marrëveshje-pazare me kohë

Nëse pronari i shtëpisë ia dorëzon shitjen një tregtari-fituesi, shpeshherë është vonë: Shtëpia do të del në shitje me një çmim spekulues shumë të lartë me ç'rast bëhet e vështirë të kalohet në pronë të qiraxhinjve.

## 3. Vetorganizimi

Bisedoni me palët tjera lidhur me mendimet dhe nevojat tuaja. Si qëndrojnë ata ndaj blerjes së mundshme dhe zgjidhjes së udhëheqjes së përbashkët? Te cilët fqinjë gjeni përkrahje dhe bashkëmendim? Nëse të gjithë bashkërisht ia mësyni të njëjtit qëllim, sukseset e parapara janë më të mëdha.

## 4. Të hollat (paratë)

Është për keqardhje por shtëpitë nuk mundë të merren falas. Lidhur me këtë duhet të mendohet: Sa para mundë të mblidhni si pronarë-qiraxhi të përbashkët? A keni farefis apo miq të cilët mundë të ju ndihmojnë duke u dhënë hua?

## 5. Kërkesë për ndihmë

Nëse situata vështirësohet ngadalë? Nuk i keni të qartë më hollësitë e pagesës? Ju nuk mundeni gjithë këte ta paramendoni? Ka imtësira burokratike, të cilat e kalojnë kuptueshmërinë tuaj? Ne ju këshillojmë dhe ndihmojmë me gjithë dëshirë.

Ne do t'ua sqarojmë mundësinë e parë dhe themelore të si të ndihmoni vetveten dhe kuptimin e udhëheqjes së përbashkët si dhe hapat e parë për blerjen e përbashkët (kolektive) të shtëpisë.

Ne do të shohim dhe përfundojmë se a mundë të ket një ardhmëri të përbashkët.

Parimisht ne jemi të hapur për shtëpia të reja të cilat bashkërisht me sindikatën e shtëpive me qira duan të udhëhiqen si shoqatë.


Këshillimet janë vetëm në gjermanisht, frengjisht, italisht dhe anglisht. Nëse doni këshilla në gjuhë tjera, ju lutemi të sillni me vete një përkthyes.

Kujdes ju lutemi: Kjo nuk është e vetmja mënyrë se si ju shkojnë punët në rast kërcënimi me humbjen e hapësirës banuese. Shumë shoqata të banorëve

e kanë fituar përsëri hapësirën e tyre të banimit me kushte të volitshme pas shumë viteve ankimesh dhe përpjekjesh.



Shtëpitë në Steinengraben, të cilat që një kohë të gjatë gjenden në pazgjidhshmëri me pronarët : Sigurimi Helvetia do që t'i rrënon për të ndërtuar ndërtesë zyresh.



Parimi themelor i sindikatës së shtëpive me qira: Pronësia individuale dhe përdorimi janë të ndara.

## Kërkoj një pasardhës social në shtëpinë time. Si duhet të bëj?

Ju keni një shtëpi dhe doni ta shitni? Ju dëshironi një zgjidhje sociale dhe dëshironi që qiraxhinjtë e njëjtë të mbeten në shtëpi? Ju nuk dëshironi që shtëpinë t'ia shitni një investuesi përfitues? Ju dëshironi që shtëpia juaj të mos bëhet mjet fitimtarësh spekulativ?

Shoqata e sindikatës së shtëpive me qira mund t'ua premtojë dhe mundësojë që shtëpia juaj edhe në të ardhmen të udhëhiqet edhe drejtohet nga një shoqatë në frymën kolektive. Ne do ta pranojmë ndërtesën për një afat të gjatë dhe nuk do të vie deri te rrënimi.